

INTERVISTA PËR RTSH

Mziu: 60% e buxhetit investohet në infrastrukturë



FAQE 5

SHËRBIME

Kujdesja për pemët dekorative, ndër punët e dobishme të Ndërmarrjes së Pastrim-Gjellbërimit



FAQE 7

SPORT

Ndeshjet e Kampionatit Evropian U-19 në stadiumin e Kamzës



FAQE 8

INVESTIMI

Rruga "Dardania", tjetër shembull i transformimit të infrastrukturës së qytetit



FAQE 5



Gazetë e Bashkisë Kamëz

KAMZA

E përdyjavshme
Nr. 205 tetor 2017
Çmimi 20 lekë
drmediakamez@gmail.com
www.kamza.gov.al

KRYEBASHKIAKU MZIU NË SCAN TV: KAMZA, ETALON I DISKRIMINIMIT NGA QEVERIA

FAQE 2-3

Bashkia, vëmendje ndaj komuniteteve rome dhe egjiptiane me politika social-ekonomike

Faqe 6

Ndërsa qeveria e majtë nuk financon asnjë projekt për qytetarët e Kamzës, Bashkia realizon dhjetëra investime

Faqe 5

Bashkia Kamëz, pjesë e projektit gjeohapësinor për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit

Faqe 7

Dy fitore radhazi të Kamzës në Superligë

Faqe 8



Premtimi i mbajtur/ Si ishte dhe si është rruga "Demokracia" në Paskuqan

FAQE 4



NË BRENDËSI

Kryebashkiaku Mziu pret përfaqësues të familjes Doçi, me rastin e emërtimit të rrugës "Llesh Zef Doçi" në Laknas

FAQE 6

Krijimi i të ardhurave, angazhim maksimal për realizimin e buxhetit deri në mbyllje të vitit

FAQE 7

Kryebashkiaku Khelal Mziu, Armando Duka dhe Dejan Savićević ndjekin ndeshjen Norvegji-Mal i Zi

FAQE 8

Vijojnë punimet në rrugën "Ejll Deda" në Paskuqan, segment rrugor me rëndësi për banorët e zonës

FAQE 5

Kamza Karate, 22 medalje në Kupën e Shqipërisë dhe paraqitje mjaft të mirë në "Struga Open 2017"

FAQE 8



Kryebashkiaku Mziu në Scan TV: Kamza është etalon i diskriminimit nga qeveria

Kryetari i Bashkisë Kamzë, z. Xhelal Mziu, ishte i ftuar në emisionin "Përtëfol" në Scan TV, ku foli për investimet e Bashkisë, impaktin që japin ato, impaktin që ka dhënë reforma administrative-territoriale, foli gjithashtu për diskriminimin e vazhdueshëm të qeverisë ndaj Bashkisë dhe qytetarëve të Kamzës. Më poshtë, intervista e plotë e kryebashkiakut Xhelal Mziu.

Mirëmëngjesi! Mirë se erdhët!

Mirëmëngjesi dhe të faleminderit për ftesën!

Jeni në mes të mandatit tuaj të tretë në krye të Bashkisë së Kamzës. Tashmë ndryshe nga mandatet e mëparshme, është një Bashki më e madhe. Ka arritur në 140 mijë banorë të regjistruar, sepse të paregjistruar mund të jenë edhe më shumë se atë. Keni edhe Paskuqanin pjesë të Bashkisë. A e ka bërë reforma territoriale këtë Bashki edhe më të fortë financiarisht, siç në fakt e kishte synimin për të gjitha njësitë vendore në vend, për 61 njësitë aktuale?

Është e vërtetë që Bashkia e Kamzës tashmë është një Bashki e madhe, për nga numri i popullsisë. Jemi Bashkia e gjashtë në Shqipëri për sa i përket numrit të popullsisë. Pas reformës territoriale ne kemi një njësi tjetër vendore bashkëngjitur, siç është zona e Paskuqanit apo ish-komuna Paskuqan dhe në këtë reformë territoriale produkti është se vetëm është rritur madhësia, madhësia e Bashkisë, pasi është bashkuar me një njësi tjetër vendore.

Në çfarë pozite financiare jeni, krahasuar me përpara reformës? Në të njëjtën pozitë apo jeni përmirësuar?

Nga ajo se çfarë u trumbetua në reformën territoriale është se asgjë nuk është arritur nga ajo, sepse pavarësisht se u bë ndarja mekanike nga 373 njësi vendore në 61 njësi vendore, shohim që jo vetëm nuk janë rritur kompetencat, jo vetëm që nuk janë rritur të ardhurat, por përkundrazi, vazhdojnë akoma sot e kësaj dite, më shumë sesa dy vite në këtë mandat, dhe ka një vakum ligjor, i cili në mënyrë të qëllimshme është lënë nga qeveria dhe për pasojë ne nuk ushtrojmë funksionet tona në zbatim të asaj.

Konkretisht, cilat janë sfidat me të cilat jeni përballur z. Mziu?

E para, kemi përfutur një njësi vendore që kishte një situatë ekonomike tejet të rënduar. Akoma edhe sot ka borxhe të trashëguara nga njësitë vendore të asaj kohe, të cilat nuk u morën përsipër nga qeveria. Së dyti, pavarësisht se u tha që do të kishte më shumë financa ndaj pushtetit vendor, në fakt ka ndodhur e kundërta, sepse më shumë sesa 50% e buxhetit që jepet drejt pushtetit vendor nuk e ka më pushteti vendor, por kjo varet nga dora e Kryeministrit, duke u dhënë në formën e granteve. Pra, jemi më pak të pavarur sot sesa para reformës territoriale dhe kjo e ka ngushtuar hapësirën dhe mundësinë e një kryetari bashkie për të ushtruar funksionin e tij në drejtim të qytetarëve, nga të cilët ka marrë votat.

Konfigurimi i ri territorial u shoqërua edhe me kalimin e një sërë kompetencash kundrejt 61 bashkive të reja, përkundër përgjegjësi të reja të shtuara. A keni marrë mbështetjen e duhur financiare për t'i realizuar ato?

Është folur shumë para reformës territoriale dhe gjatë këtyre dy viteve se kanë kaluar disa kompetenca drejt pushtetit vendor edhe



thuhet që kanë kaluar shtatë kompetenca të tjera, të reja, të cilat i kanë dhënë më shumë autonomi pushtetit vendor, por e vërteta është ndryshe. Kanë kaluar këto shtatë kompetenca, siç është arsimiti parashkollor, siç është mirëmbajtja e rrugëve, pyjet dhe kullotat, siç janë zjarrfikëset, siç janë qendrat ditore apo kolektorët vaditës dhe kullues e disa funksione të tjera. Por, ajo çfarë ka ndodhur, në fakt, është vetëm se ka kaluar fatura financiare e këtyre kompetencave. Pra, nuk është shoqëruar me një kosto të hartuar financiare së pari drejt këtyre bashkive dhe, së dyti, këto bashki nuk kanë asnjë lloj influence për ushtrimin e këtij funksioni.

Në një situatë të tillë, të marrim një rast konkret...

Po shohim arsimin. Çfarë roli ka Bashkia kundrejt arsimit në Kamzë? Ka kaluar arsimiti parashkollor dhe personeli ndihmës parauniversitar. Të dyja këto funksione që kanë kaluar, nuk janë shoqëruar me pagesa ekstra personeli që ne të merremi me pagat dhe sigurimet shoqërore të këtij personeli, çfarë do të thotë që ne do shpenzojmë më shumë. Kemi ngritur një strukturë të caktuar të zyrës Arsimore por edhe të asaj të Financës për të bërë pagat, që do të thotë se është prekur buxheti i Bashkisë. Më kryesorja është që ne jemi kthyer vetëm thjesht në bërjen e pagave. Asnjë lloj influence, as për emërimin, as për largimin nga puna, asnjë lloj kompetence.

Pjesa e investimeve si mbulohet, teksa po i referohemi si sektor arsimit?

Tek arsimit, konkretisht në zonën e Kamzës, sot e pesë vite nuk kemi marrë asnjë financim, as për shkollat, ndërtime të reja dhe kopshte, për të cilat ka nevojë qyteti, as për ristrukturime, të cilat kanë nevojë për t'i ristrukturuar. Pra, edhe në këtë drejtim kemi mjaft vakume të krijuara. Nëse u referohemi fushave të tjera, siç janë zjarrfikëset - ju e dini shumë mirë që zjarri këtë vit në Shqipëri ishte i përhapur në çdo vend...

Kishit probleme si Bashki? U prekët?

Kishim probleme edhe ne si Bashki, por çudia ndodh, se ne nuk kemi reparat zjarrfikësesh, nuk kemi asnjë zjarrfikëse. Madje, edhe pse ishte reparti i zjarrfikësive para ndarjes

së kompetencave, në Kodër-Kamzë, që i përkiste Bashkisë së Kamzës, sot ky reparat menaxhohet nga Bashkia e Tiranës. Nëse do ndodhë zjarr në qytetin e Kamzës dhe të Paskuqanit, atëherë duhet t'u drejtohem bashkive të tjera analoge për të na ardhur në ndihmë, për shkak të zjarrit dhe kjo është e papranueshme, pavarësisht se ne duhet ta merrnim që në ndarjen e re territoriale. Është një problem ky që gjendet edhe në bashkitë fqinje me Kamzën apo vetëm Kamza e ka këtë problem?

Në përgjithësi, në bashkitë të cilat janë fituar nga e djathta ndodhin situata persekutimi dhe pothuajse të 15 bashkitë, të cilat drejtohen nga të djathtët, sot kanë probleme të tilla, por të paktën Kamza është një nga ato të cilat nuk ka deleguar asnjë nga këto kompetenca. I referohemi edhe një herë tjetër situatës. Kemi p.sh. një konvikt shkollë brenda qytetit të Kamzës, siç është konvikti i shkollës "Loro Boriçi", dhe nuk menaxhohet nga Bashkia e Kamzës, por brenda territorit tonë menaxhohet nga Bashkia e Tiranës. Është një mosmarrëveshje me Bashkinë e Tiranës për ndarje kompetencash?

Jo, nuk është mosmarrëveshje, sepse nuk varet nga Bashkia e Tiranës, por është qeveria e cila bën veprime të tilla selektive. Ose, kemi qendrën ditore për të moshuarit, e cila funksionon që nga viti '70 në Kamzë. Të gjitha kanë kaluar në menaxhimin e pushtetit vendor shoqëruar edhe me financime, kurse në Kamzë akoma s'ka kaluar. U blenë 61 ekskavatorë për 61 bashki dhe ekskavatorin e Kamzës ia dhanë Tiranës. Pra, ky është një diskriminim.

Pra, aktualisht ju nuk keni as mjete për të punuar për hapjen dhe mbajtjen në kontroll të kanaleve kulluese në sipërfaqet bujqësore?

Absolutisht, asnjë. Jo vetëm që nuk u është deleguar nga rishpërndarja atyre drejtorive të cilat ishin para ndarjes territoriale, por edhe blerje të reja të cilat kanë nuk i janë dhënë Bashkisë së Kamzës.

Reforma administrativo-territoriale synoi konsolidimin e njësisve të vogla të qeverisjes vendore në njësi më të mëdha dhe më efektive, duke pasur në thelb edhe një shërbim më të mirë për qytetarët. A u shërbehet më

mirë qytetarëve të Kamzës? Ka ndryshuar diçka në raport me shërbimet që ata kërkojnë pranë institucionit të Bashkisë?

Ajo çfarë është e rëndësishme, është që ndarja territoriale është e pranueshme, sepse kishte njësi vendore të cilat ishin në numër shumë të vogël dhe ishte e pamundur për t'u shërbyer. Pra, unë nuk jam kundër ndarjes territoriale, ndonëse kjo ndarje territoriale nuk ka qenë në standardin që duhej dhe ka pasur politizim të situatës së ndarjes territoriale. Por ajo çfarë ka ndodhur njëherë, është që u tha: 'Ndarja territoriale do të kursejë nga fondi i pagave dhe i sigurimeve shoqërore' dhe jepeshin shifra me miliona euro, 80 milionë euro thuhej që do të kurseheshin vetëm nga fondi i pagave. Në fakt, ndodhi e kundërta. Në Bashkinë e Kamzës numri i punonjësve është shtuar shumë më pak sesa i takon nga bashkimi i këtyre njësisve vendore... por nëse shohim vetëm Bashkinë e Tiranës, shohim se numri i të punësuarve nga bashkimi i Bashkisë së qendrës me njësitë e tjera vendore është rritur ndjeshëm dhe ky fenomen ka ndodhur në gjithë Shqipërinë. Pra, jo vetëm që nuk janë kursyer 80 milionë euro, por nga njësitë vendore është shpenzuar shumë herë më shumë se më parë për personelin administrativ, çfarë do të thotë që nuk ka sjellë më pak kursime, por ka sjellë më shumë shpenzime në drejtim të personelit.

“Janë rreth 60 projekte që po financohen nga Bashkia këtë vit, që tregojnë edhe një herë gatishmërinë, angazhimin e Bashkisë për të qenë pranë qytetarëve në investime”.

Ju e prekët paska çështjen e investimeve më herët. Unë dua t'i referohem Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare kundrejt zhvillimit rajonal dhe lokal. Si gjendet Bashkia e Kamzës përkundrejt projekteve që financon, që tenderon Fondi Shqiptar i Zhvillimit? Gjatë këtyre viteve të qeverisjes "Rama" janë shpikur disa lloj instrumentesh, me qëllimin për t'i bërë bashkitë më autonome, por në të vërtetë absolutisht asgjë s'ka ndryshuar. Jo vetëm që s'ka ndryshuar, por përkundrazi është politizuar edhe një herë situata, sepse më përpara ishte Autoriteti Rrugor, ishte edhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Ishin dy institucione të cilat ne dërgonim projektet dhe ishin më të kualifikuara dhe gjenim hapësirë për financim. Sot janë bërë Fondi i Zhvillimit Rajonal, i cili pavarësisht se ka dy vite se funksionari, në fakt akoma nuk e ka gjetur



veten, nuk ka pasur financimet e nevojshme, por ajo çfarë më kryesorja, është që tashmë kujtudo që t'ia adresosh, qoftë edhe Autoriteti Rrugor, apo Fondi Shqiptar i Zhvillimit, apo te AZHR-ja, apo te financimet e tjera kur hapet portali online sipas specifikave të caktuara...

Teksa i përmendni, duket se keni më shumë akses për të aplikuar.

Po, është rritur numri i aplikimeve, por përfitimi zero. Për dy vite në këtë mandat, unë kam aplikuar me më shumë sesa 137 projekte tek të gjitha këto institucione.

Të fokusuar në infrastrukturë?

Të fokusuar në nevojat tek nevojat të cilat i ka qyteti, siç është infrastruktura rrugore, ajo e ujësjellësit, kanalizimeve, e rivitalizimeve urbane, e ndërtimit të shkollave, ndërtimit të kopshteve.

Pra, 137 projekte. Për sa prej tyre keni arritur të fitoni fondet?

Zero financime, madje janë projekte më në nevojë se në asnjë qytet tjetër. Kemi dy qendra urbane: qendra e Kamzës dhe qendra e Paskuqanit. Të dyja qytete historike, të cilat kanë vite apo dekada. Pavarësisht se kemi dërguar projekte, nuk është bërë financimi i tyre. Kemi rrugë që kanë ndikim të jashtëzakonshëm social dhe ekonomik, por nuk ka ndodhur financimi i tyre. Kemi lagje të tëra me mijëra nxënës, të cilët nuk kanë një shkollë, nuk kanë një kopsht, nuk është bërë financimi i tyre. Pra, është rritur numri i institucioneve ku ne mund të aplikojmë, por është zvogëluar në zero mundësia e marrjes së këtij financimi.

Këto aplikime i keni bërë nga viti 2015?

Që nga viti 2015 deri sot në këto dy vite, janë 137 projekte, të cilat janë hartuar konform çdo standardi dhe s'është marrë asnjë financim.

Cili ka qenë argumenti i institucioneve ku ju keni aplikuar?

Çudia ndodh, jo vetëm që bëjmë aplikime, por nuk kthehet asnjë përgjigje, qoftë minimale për të thënë që X projekt nuk financohet sepse nuk plotëson pikavrazhin për këto arsye, ose nuk është social, ose nuk është fizibël apo të tjera argumente, por nuk kthejnë asnjë përgjigje në asnjërin nga këto portale aplikimesh, apo nga Ministria, apo qeverisja qendrore.

Ndarja në 4 agjenci për zhvillimin rajonal ku mund të aplikohet, ku mund të konkurrohet brenda rajoneve tashmë, e bën më të drejtë garën në gjykimin tuaj? Konkretisht, Kamza do jetë me Tiranën dhe Dibrën?

Janë tre qarqe: Qarku i Tiranës, i Dibrës dhe i Durrësit. Jemi tre qarqe dhe kjo agjenci ka rreth dy vite që ka filluar dhe, në fakt, vetëm në formalitetet kemi shkuar në këto momente. Ka bërë nja dy-tre financime, kuptohet, përsëri me ngjyrimet politike, ka bërë në Durrës, Tiranë dhe në Bulqizë.

A jeni pjesë e bordit tashmë?

Jam pjesë e bordit, por në minorancë në vendimarrje.

Kështu që, as në këtë Fond nuk mendoni se do të gjeni zgjidhjen?

Zgjidhja e vetme është vetëm një, kur funksionon ligji. Ligji për pushtetin vendor duhet të jetë i përcaktuar qartë, fondi i cili destinohet në drejtim të pushtetit vendor duhet të ketë vetëm një kriter. Kriteri i numrit të popullsisë dhe ajo çka mund t'i lihet në dorë agjencisë, është për të përcaktuar agjencia se cili nga projektet është më konkurrues, por pjesa që i takon një qyteti duhet patjetër që ta

marrë. Nëse unë kam dërguar 137 projekte, nuk është e thënë që unë të financoj këto 137 projekte, por këto agjenci mund të bëjnë selektimin për të parë se cilët nga këto projekte është më konkurrues.



Në mungesë të mbështetjes nga qeveria qendrore, siç edhe e thonë për shumë projekte mbi 130 si po investoni, ku po i gjen fondet Bashkia Kamzë? Keni gjetur donatorë të huaj? Të ardhurat tuaja i përballojnë investimet dhe ku janë fokusuar ato?

Në fakt, kjo pabarazi që ka ndodhur nuk ka ndodhur asnjëherë në këto vite dhe Kamza është një qytet i cili është etalon i këtij diskriminimi. Nëse në këto 4 vite, ka filluar viti i 5-të ose viti i parë i mandatit të dytë të kësaj qeverie, kemi dërguar projekte pafundësisht dhe asnjë financim. Sot në



qytetin e Kamzës, pavarësisht që jemi qyteti i gjashtë, qeveria ka bërë vetëm një financim, restaurimin e një qendre shëndetësore, një qendër shëndetësore dykatëshe. Imagjinoni se sa është financimi i saj. Cila është arsyeja se pse nuk ka bërë financime? Sepse rreth 50 apo 52% e asaj zone kanë votuar djathtas, por ama 48% e tyre kanë votuar majtas.

Kështu besoni ju që qeveria ju ka lënë mënjatë për shkak të bindjeve politike?

Kjo është e vërtetë. Unë kam një statistikë të granteve të akorduara nga qeveria në këto katër vite edhe në 61 bashki, pavarësisht se jemi të 6-tët, ne renditemi të 61-tët për sa i përket përfitimit. E dhashë këtë shembull për të treguar që qeveria zero financim, pavarësisht që ka 48% të banorëve që kanë votuar majtas. Në këto dy vite mandat unë kam financuar ndjeshëm në qytetin e Kamzës. Kam financuar në rrugë, në kanalizime, në ujësjellës apo në financime të tjera.

Keni gjetur donatorë të huaj apo të gjitha këto janë me të ardhurat e Bashkisë?

Dua të dal diku tjetër. Në të gjitha financimet që kam bërë, nuk kam parë se kush ka

votuar kundër meje. Aq më tepër, unë e kam pasur në mënyrë më të drejtpërdrejtë se sa nga Kryeministri, por unë kam financuar aty ku ka qenë nevoja. Kam financuar në rrugë, në atë qendër votimi ndoshta kam humbur ndjeshëm, por nëse unë do të merrja

selektimin politik, sipas Kryeministrit, i binte të mos bëja financime në atë zonë.

Jeni kryetar i gjithë Bashkisë Kamzë...

Por edhe Kryeministri është i gjithë shqiptarëve, sepse është mandatar. Ndaj, e dhashë këtë shembull për të treguar diskriminim që bën Kryeministri, por në fakt diskriminim që nuk e bën asnjë kryetar bashkie, as unë dhe asnjë tjetër dhe kjo ka bërë që unë të gjej instrumentet për të rritur të ardhurat nëpërmjet paketash fiskale konkurruese, duke i ulur tarifatat, por duke zhdukur informalitetin, por duke gjetur

Absolutisht që asnjë lloj shansi, ndaj edhe unë thashë që më pak se 20% e buxhetit të Bashkisë shkon për paga dhe sigurime shoqërore. Unë jo vetëm që nuk ndodhem në vështirësi, por 60% e buxhetit shkon për investime. Mjafton po të shkojmë në zonën e Paskuqanit, e cila kishte vite që nuk ishte financuar dhe të shohësh një rrugë, siç është bulevardi "Demokracia" që ka një gjatësi prej 7 km dhe me një gjerësi prej 12 m, pavarësisht që e kemi dërguar me dhjetëra herë te qeveria për ta financuar, nuk e financoi. Është një rrugë që u shërben jo vetëm banorëve të Paskuqanit dhe Kamzës, por edhe të Tiranës dhe që është financuar totalisht me buxhetin e Bashkisë dhe që ka një vlerë më shumë sesa 25 miliardë lekë. Mjafton po të shohësh qendrën urbane të Babrrusë ose të Paskuqanit, e cila, pavarësisht se ishte ndër projektet më konkurruese në Shqipëri, nuk u financua nga qeveria. Kush është më konkurruese: qendra e Poliçanit? Maksimumi i gjithë Poliçani ka 3 mijë banorë dhe që është financuar. Po të shohësh pallatet, s'ka asnjë person aty në pallate, sepse kanë ikur - apo qendra e Kamzës dhe qendra e Paskuqanit? Qendra e Paskuqanit ka 50 mijë banorë, ndërsa qendra e Kamzës ka 100 mijë. Numri i njerëzve përcakton se sa fizibël është një projekt. Janë rreth 60 projekte që po financohen në këtë vit, që tregojnë edhe një herë gatishmërinë, angazhimin e Bashkisë për të qenë pranë qytetarëve në investime.

Bashkia duket se u ka kushtuar një vëmendje të rëndësishme edhe aktiviteteve kulturore dhe sportive. Ekipi i Kamzës është tashmë në Superligë. Cilat janë synimet e këtij ekipi?

Besoj që nuk janë veç investimet për të cilat kanë nevojë qytetarët, kanë nevojë edhe për aspektin social apo edhe për atë kulturor dhe sportiv. Po të shohësh, ne kemi një pallat kulture, i cili në mënyrë të vazhdueshme organizon aktivitete për të cilat ka nevojë qyteti.

Dukshëm ka ofruar gjallëri në fakt...

Kemi edhe aktivitete sportive. Kemi ekipin e basketbollit, i cili ka mbi 7 vite që është krijuar si ekip dhe në këto 7 vite kemi bërë tripletë trofesh, kemi dalë kampion të Shqipërisë, kemi fituar kupa, superkupa, çfarë do të thotë që është bërë një komponent i rëndësishëm për qytetin, por jo që vetëm kemi ekipin e të rriturve, por kemi ngritur ekipin e moshave, çka do të thotë që në çdo shkollë apo në çdo lagje fëmijët në Kamzë merren me basketboll. Kemi ekipin e mundjes apo ekipin e shahut apo ekepe të tjera. Por, kemi edhe ekipin e futbollit, i cili në këtë vit është në Superligë dhe jam i bindur që ekipi i futbollit në këtë vit, falë angazhimit për infrastrukturën që kemi te stadiumi, por edhe mbështetjes së Bashkisë, jo vetëm që do të jetë pjesë e Superligës, por pse jo edhe të jetë një ekip konkurrues për këtë vit.

Vendet e para i synoni?

Nëse nuk do jemi në 2-3 vendet e para, jam i sigurt që do të jemi në mesin e tabelës.

Faleminderit që ishit këtu me ne në këtë mëngjes! Ju uroj punë të mbarë z. Mziu!

Faleminderit dhe kënaqësi edhe për mua që isha në emisionin tuaj.





Kryebashkiaku Xhelal Mziu inspekton punimet për asfaltimin përfundimtar të lotit 2 në rrugën “Demokracia” në Paskuqan

Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, inspektoi punimet në lotin e dytë të rrugës “Demokracia” në Paskuqan, një investim i Bashkisë, me vlerë mbi 2.5 miliardë lekë. Gjatë inspektimit kryebashkiaku Mziu u shpreh: “Jemi në inaugurimin e lotit të dytë të rrugës “Demokracia” në Paskuqan.

Është një investim i financuar 100% nga buxheti i Bashkisë. Ishin 3 lote të financuara nga Bashkia që kanë një vlerë më shumë sesa 2.5 miliardë lekë.

Ishte kërkuar për më shumë sesa katër investimi i kësaj rruge me buxhetin e shtetit, po pavarësisht se ishte projekti më i rëndësishëm i Bashkisë Kamëz, që kishte një impakt për Paskuqanin, për Kamzën, por edhe për Tiranën, nuk u mundësua



financimi i saj për arsye politike. Investimi i kësaj rruge, jam i sigurt, që do të japë një impakt të jashtëzakonshëm social, por edhe ekonomik në këtë zonë.


Mosfinancimi nga buxheti i shtetit, por financimi i saj vetëm me të ardhurat e Bashkisë ka cunguar investimet në sektorë të tjerë të Kamzës.

S’më ngelet gjë tjetër veçse t’i uroj edhe një herë banorët e kësaj rruge që ta gëzojnë këtë rrugë dhe ndërkohë të impulsojë zhvillimin e biznesit në të mirë të qytetarëve, në rritjen e numrit të punësuarve dhe ndërkohë edhe rritjen e investimeve, për shkak të rritjes së të ardhurave të Bashkisë”.

Si ishte dhe si është rruga “Demokracia” në Paskuqan

Si ka ndryshuar rruga “Demokracia” në Paskuqan pas investimit të Bashkisë. Ky është premtimi i mbajtur i kryebashkiakut Xhelal Mziu. Bashkia Kamëz, e angazhuar që të shtojë investimet publike, pavarësisht diskriminimit të qeverisë, e cila nuk financon asnjë projekt për qytetarët.





Kryebashkiaku Xhelal Mziu për RTSH: 60% e buxhetit investohet në infrastrukturë

Kamza është qyteti më i ri i vendit, vetëm 21 vjeç, i krijuar gjatë viteve të tranzicionit. Qyteti që nisi të popullohej me ndërtime informale në vitet '90, është sot qyteti i kontrasteve të mëdha.

Shumëkush e lidh me emrat e pazakontë që u janë vënë rrugëve të kësaj Bashkie. Por kryetari i Bashkisë, Xhelal Mziu, e ka një përgjigje sa i përket përzgjedhjes së emrave të rrugëve.

“Është më mirë të vendosësh emrat e qyteteve të Shqipërisë, është më mirë të vendosësh emrat e mbi 200 ish-komunave të Shqipërisë, është më mirë të vendosësh emrat e artit dhe të kulturës, patriotë të cilët kanë dhënë vlera për këto 100 vite, është më mirë të vendosësh emrat e ndonjë personaliteti ndërkombëtar, i cili ka luajtur rol jo vetëm për Shqipërinë, por edhe më gjerë se kaq sesa të vendosësh emrat e dëshmorëve anonimë të Luftës Nacional-Çlirimtare”.

Përtej emrave të rrugëve, kryetari i Bashkisë së Kamzës thotë se investimet kryesore nga buxheti i Bashkisë gjatë 3 mandateve të tij kanë shkuar për infrastrukturën rrugore.

Buxheti i Bashkisë edhe këtë vit është 1.5 miliard lekë, por Mziu thotë se Bashkia e



Kamzës, e 6-ta më e madhja në vend, ka nevojë edhe për mbështetjen financiare të qeverisjes qendrore.

“Kemi aplikuar jo pak, por 137 projekte në këto 4 vite e pak te qeveria, por asnjë nga këto nuk ka gjetur financim”.

Ndër investimet kryesore të Bashkisë Xhelal Mziu përmend ndërhyrjen në bulevardin “Demokracia” në Paskuqan me një gjatësi prej 7 km dhe përfundimin e fazës së parë të ndërtimit të rrjetit të ujësjellësit, të financuar

“Kemi aplikuar jo pak, por 137 projekte në këto 4 vite e pak te qeveria, por asnjë nga këto nuk ka gjetur financim”.

nga Banka Botërore, me vlerë totale 55 mln euro.

marrë nga rtsh.al, 14 tetor 2017

Rruga “Dardania” në lagjen 5 Kamëz, një tjetër shembull se si po transformohet infrastruktura e qytetit falë punës së Bashkisë



Investimeve për vitin 2017 do t'u shtohet edhe një rrugë e re me standarde bashkëkohore, rruga “Dardania” në lagjen 5 Kamëz, që është një tjetër shembull se si po transformohet infrastruktura e qytetit, falë punës së Bashkisë. Kjo rrugë është një tjetër investim që i shtohet lagjes 5 Kamëz në vitin 2017. Rruga “Dardania” është një segment që lidh banorët e zonës me rrugën “Miqësia” dhe me rrugën “Azem Hajdari”, të cilat kryqëzohen me bulevardin “Berisha”. Projekti i këtij segmenti rrugor, ku do të investohet, ka gjatësi rreth 420 ml. Rruga “Dardania” ka një rëndësi të veçantë për zonën, pasi jep impakt mjaft pozitiv për banorët e saj, duke qenë se ndodhet në një nga lagjet më të populluara të qytetit, ku jeton një pjesë e konsiderueshme e komunitetit. Duke pasur parasysh që kjo zonë është në zhvillim e sipër, projekti i rrugës është bërë me parametra që t'i përshtaten zhvillimit të zonës, si dhe duke pasur parasysh edhe kërkesat dhe nevojat e vetë qytetarëve, për të pasur lirshmëri në hyrje-daljet nga shtëpitë, por edhe lehtësimin e lëvizjes gjatë gjithë segmentit rrugor.

Ndërsa qeveria e majtë nuk financon asnjë projekt për qytetarët e Kamzës, Bashkia realizon dhjetëra investime



Ndërsa qeveria e majtë që prej katër vitësh nuk financon asnjë projekt për qytetarët e Kamzës, Bashkia vijon punën duke realizuar dhjetëra investime.

Një prej tyre është edhe rruga “Arben Broci” në Paskuqan. Mes shumë projekteve të Bashkisë Kamëz që po zbatohen në këtë zonë, është edhe ndërtimi i rrugës “Arben Broci” në lagjen Paskuqan 2 bashkë me rrjetin e kanalizimeve në këtë segment.

Ky investim merr një rëndësi të veçantë, jo thjesht për faktin se ka një gjatësi të konsiderueshme prej 685 ml, por sepse do të ketë infrastrukturë të plotësuar rrugore dhe infrastrukturë nëntokësore.

Gjithashtu, gjerësia e saj do të jetë 8 ml, me kuletë anash, si dhe me trotuare 2.5 ml në të dyja anët e saj.

Përveç përmirësimit të infrastrukturës, realizimi i këtij projekti do të ndikojë edhe në zhvillimin e bizneseve ekzistuese, si dhe në çeljen e aktiviteteve të reja të sipërmarrjes së lirë.

Ky investim është pjesë e një projekti të madh që përfshin disa projekte, siç është ndërtimi i rrugës dhe i KUN “Arben Broci”, rruga për te qendra QTA, vazhdimi i shkarkimit të kanalit të liqenit.

Vijojnë punimet në rrugën “Ejll Deda” në Paskuqan, segment rrugor me rëndësi për banorët e zonës

Pas premtimit të mbajtur për rehabilitimin e plotë të rrugës “Demokracia” në Paskuqan me gjatësi 7 km, Bashkia Kamëz është e vendosur të realizojë urbanizimin e të gjitha lagjeve të kësaj zone, duke e ndryshuar tërësisht gjendjen e trashëguar të infrastrukturës.

Një nga shembujt konkretë të punës intensive është ndërtimi i rrugës “Ejll Deda” në lagjen Paskuqan 2.

Për katër vite me radhë qeveria e majtë diskriminon qytetarët dhe Bashkinë e Kamzës, duke mos dhënë asnjë qindarkë për projekte jetike.

Ndërkaq, Bashkia me të ardhurat e veta ka realizuar qindra investime në këto vite.



Vetëm për vitin 2017 janë 60 projekte infrastrukturore që Bashkia Kamëz i ka parashikuar në buxhetin e saj dhe po i realizon ditë pas dite.

Rruga “Ejll Deda” është pjesë e një projekti të madh që përfshin edhe dy rrugë të tjera, “Ismail Qemali” dhe “Isuf Xhelili”.

Ndërtimi i këtyre rrugëve përbën një prej momenteve më të rëndësishme të krijimit të një infrastrukture bashkëkohore në zonën e Paskuqanit, gjë e cila ka munguar deri tani.

Ky është edhe angazhimi kryesor i kryebashkiakut Xhelal Mziu, gjithashtu dhe një premtim i realizuar tashmë.



Kryebashkiaku Mziu në takim me NDI: Bashkia, vëmendje ndaj komuniteteve rome dhe egjiptiane me politika social-ekonomike

Kryebashkiaku Xhelal Mziu priti në një takim të posaçëm një delegacion të New Day Impact Foundation, të kryesuar nga presidenti i këtij fondacioni, z. Paul de Lange. Takimi kishte si mision ndërtimin e një qendre shumëfunktionale për edukimin e fëmijëve, të rinjve dhe të rejave të komuniteteve me prejardhje rome dhe egjiptiane.

Paul de Lange, president i New Day Impact, në emër të delegacionit tha se është një qëllim i përbashkët me institucionin e Bashkisë integrimi i plotë të këtyre komuniteteve në jetën normale të qytetarëve të Kamzës. Qendra si qëllim parësor ka edukimin e gjerë të këtyre komuniteteve si dhe përafrimin e tyre me rrjedhën normale të qytetit dhe si rrjedhim përafrimin e kulturës në përfaqësim komunitar. “Për të realizuar këtë nga ana jonë, - theksoi z. Paul de Lange, - ju drejtohem i kryetar që a është e mundur nga ana e Bashkisë të na sigurohet sipërfaqja e truallit që do të shërbejë për ndërtimin e kësaj qendre të edukimit? Ne, kur vendosim për të realizuar një projekt të tillë, jemi të përkushtuar për ta çuar deri në fund projektin. Së dyti, dua të theksoj në këtë takim se kemi një projekt të detajuar për ndërtimin e ndërtesave sociale në ndihmë të familjeve rome dhe egjiptiane”.

Pas fjalës prezantuese të projektit nga z. Paul de Lange, fjalën e mori kryebashkiaku Mziu. Ai shprehu falënderimin për praninë e këtij delegacioni, të cilin e quajti si një delegacion për nga kompozimi si ai i Parlamentit Evropian dhe për vetë rëndësinë që pati ky përfaqësim. Z. Mziu theksoi bashkëpunimin e suksesshëm në këto vite me NDI dhe suksesin e padiskutueshëm në projektet e deritanishme që ka pasur në Bashkinë Kamëz ky fondacion. Pasi bëri një përmbledhje të shkurtër të ndryshimit të qytetit të Kamzës nga viti 1990 dhe deri më sot, ai vlerësoi se ndryshimi i thellë në gjithë këto vite ka ardhur jo vetëm si rezultat i punës së kryer nga Bashkia, por edhe nga partneriteti dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm që ka pasur dhe ka Bashkia me



organizatat dhe institucionet më prestigjioze evropiane dhe ato botërore.

Ndër shumë elemente që përmendi z. Mziu, një nga treguesit kryesorë është që qyteti ka një migrim nga e gjithë Shqipëria, rritje popullore nga viti në vit dhe fakti se Kamza, si asnjë qytet tjetër në vend, ka një moshë mesatare 4 vite më të ulët se mesatarja kombëtare.

“Nga monitorimi i terrenit janë verifikuar që vetëm përgjatë argjinaturës së lumit të Tiranës janë konstatuar 200 individë që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian. Duke marrë në konsideratë problematikat e shumta që kanë këto komunitete edhe Bashkia Kamëz ka hartuar politikën e saj strategjike për t'i ardhur në ndihmë komunitetit rom dhe egjiptian. Kamza ka numrin më të madh në mbarë vendin për njësi popullore me këto komunitete. Sot në Kamëz numërohen katër vatra ku janë të lokalizuara aktualisht komunitetet rome dhe egjiptiane. Ato janë të migrueshëm dhe nuk kanë një qëndrueshmëri, por gjithmonë janë pasur nën vëmendjen e mbështetjes nga Bashkia me politika social-ekonomike. Kështu vatra nr. 1 ndodhet në Valias, vatra

nr. 2 ndodhet në lagjen 5 Bathore, vatra nr. 3 përgjatë argjinaturës së Zall-Mnerit dhe vatra nr. 4 përgjatë argjinaturës së lumit Tirana që përshkon Babrronin. Bashkia Kamëz, edhe pse ka treguar një interesim të jashtëzakonshëm për këto përfaqësime, përsëri nuk ka kapacitetet e duhura financiare për të përballuar nevojat e plota që kanë familjet rome dhe egjiptiane. Vlerësoj kontributin tuaj dhe e çmoj shumë atë dhe gjej rastin për të shprehur gatishtësinë time maksimale për të zgjeruar bashkëpunimin jo vetëm për zbatimin e projekteve të radhës, por edhe për të krijuar linjat e tjera të domosdoshme për mbështetjen që u keni dhënë qytetarëve të Kamzës”, - theksoi kryebashkiaku Mziu. “Jam i gatshëm, - vijoi ai, - qysh nga ky moment të vë në dispozicion të zbatimit të projekteve të gjithë kapacitetin e nevojshëm të pronës publike që është në juridiksion të Bashkisë Kamëz për përfundimin me sukses të projekteve konkrete që ju keni. Së dyti, jam po aq i gatshëm për të ndërtuar infrastrukturën e nevojshme për ndërtimin e objekteve me interes komunitar”. Më pas, kreu i Bashkisë tha: “Dua t'ju sjell në vëmendje gjatë këtij takimi që qeveria qendrore nuk ka alokuar

“ Takimi me delegacionin e New Day Impact Foundation kishte si mision ndërtimin e një qendre shumëfunktionale për edukimin e fëmijëve, të rinjve dhe të rejave të komuniteteve me prejardhje rome dhe egjiptiane. ”

asnjë qindarkë për Bashkinë Kamëz, përfshirë këtu financime për t'u ardhur në ndihmë komuniteteve rome dhe egjiptiane. Ajo zbatoi projektin e rehabilitimit të lumit të Tiranës deri në kufirin gjeografik me Bashkinë Kamëz dhe duke grumbulluar të gjithë materialin e mbledhur në këtë kufi, gjë që bëri që ardhja e furishme e lumit të Tiranës të kapërcente pragjet mbrojtëse duke përmbytur të gjitha shtëpitë e familjeve rome dhe egjiptiane, të cilat janë të ndërtuara përgjatë argjinaturës së Zall-Mnerit. Bashkia Kamëz ndërhyri me investime të cilat kapin shifrat e rreth 400.000 eurove dhe duke ndërrhyrë në buxhet dhe duke minimizuar investimet në drejtime të tjera të domosdoshme për qytetarët e Kamzës. Ky diskriminim ka vazhduar këta katër vjet me qytetarët e Kamzës në të gjitha drejtimet nga qeverisja qendrore. E ndodhur në këto situata, Bashkia Kamëz ka ruajtur trendin e bashkëpunimit me institucionet e huaja si dhe binjakëzimet me qeverisje simotra që janë shtrirë në shumë vende të Bashkimit Evropian, duke sjellë përfitime të drejtpërdrejta në investime për qytetarët e Kamzës. Ky është një moment që ne kemi në vëmendjen tonë maksimale për të rritur partneritetin me organizmat ndërkombëtarë, duke qenë partnerë seriozë në bashkëpunimin afatgjatë”, - theksoi kryebashkiaku Mziu në përfundimin e fjalës së tij.

Kryebashkiaku Xhelal Mziu pret përfaqësues të familjes Doçi, me rastin e emërimit të rrugës “Llesh Zef Doçi” në Laknas

Kryebashkiaku Xhelal Mziu priti në ambientet e zyrës së tij përfaqësues të familjes Doçi me rastin e vendosjes së emrit të rrugës “Llesh Zef Doçi” në një nga investimet e shumta të Bashkisë Kamëz të kryera në Laknas.

Vendosja e emrit rrugës është përligje e figurës historike të Llesh Zef Doçit, si një nga njerëzit më të spikatur të fisit Doçi në Lurë. Si një intelektual me përgjegjësi të mëdha në detyra shtetërore, por edhe si një kontribuues në shuarjen e gjakrave, kryesisht në zonën e Veriut, figura e Lleshit u përhap jo vetëm në Lurë, por edhe në Mirditë, Lezhë, Kukës e kudo që ka pasur fenomene të gjakmarrjes në Shqipëri. Kjo ka bërë që historia të flasë vetë për Llesh Zef Doçin.

“Janë vendosur rreth 700 emra rrugësh në qytetin e Kamzës, e cila deri në vitin 2009 nuk kishte sistem adresash dhe duke mos pasur fare referenca. Kryesisht në këto emërime rrugësh është vendosur sistemi i përzgjedhjes nga personalitete të shquara të artit, kulturës, sportit dhe figurave mjaft të shquara të autorëve të huaj që jo në pak raste disa prej tyre kanë dhënë kontribute të drejtpërdrejta për Bashkinë Kamëz. Kështu që, jam i kënaqur që ndër këto personalitete zë vend edhe Llesh Zef Doçi. Meqë dhe pak ditë na ndajnë nga 90-vjetori i lindjes së tij, dëshiroj që t'ju vlerësoj për figurën e tij historike vendosjen emrit



rrugës në Laknas, “Llesh Zef Doçi”, - u shpreh z. Mziu gjatë takimit. Në emër të familjes së Llesh Zef Doçit, pjesëtarët e saj falënderuan kryebashkiakun Mziu jo vetëm për vlerësimin e figurës së z. Doçi, por edhe për kontributin e tij të pashtershëm për transformimin rrënjësor të qytetit të Kamzës.

Mirela Kumbaro, kjo “këmborë” e Ramës, e skandaleve financiare, shkatërrimit të Butrintit, fyen rininë e Kamzës

Mirela Kumbaro, e cila asnjë ditë të vetme nuk ka ushtruar detyrën për të cilën gjendet në karrigen e ministres së Kulturës, e konfirmuar çuditërisht sërish edhe në mandatin e dytë të Ramës, e gjendur mes skandalesh financiare dhe shkatërrimit të veprave të artit, i thellon më tej ato. “Këmbora” e qeverisë “Rama” në mënyrë të paturpshme, teksa rrekej të justifikonte skandalet e saj, duke mos thënë asgjë për to, ka kapërcyer degë më degë duke sulmuar të rinjtë e Kamzës, duke i fyer ata madje dhe për sa i përket origjinës së tyre. “Të rinjtë e Kamzës nuk kanë shkuar në opera kurrë dhe se duhet t'i edukojmë”, - thotë kjo mediokre që paguhet nga taksat e shqiptarëve dhe të banorëve të Kamzës. E gjendur në qendër të sulmeve, kjo medikore dhe shkatërruese e veprave të artit dhe kulturës shqiptare, nuk u bë kurrë asnjë ditë të vetme ministre e Kulturës, por veç numëron skandalet

e saj. Mirela Kumbaro, veç skandaleve financiare të raportuara në media, ku Ministria e drejtuar prej saj ka dhënë miliona lekë pa tenderim, një skandal ky i pashoq që tregon se si Kumbaro u jep kompanive të ndryshme gati gjysmë miliardë lekë pa garë, tani i është sulur edhe Butrintit. Nën hundën e Kumbaros po shkatërrohet sot Butrinti. Mediat, ekspertët, ligjvënësit kanë dhënë alarmin për ndërtimin pa leje që po ngrihet në Butrintit dhe kjo “këmborë” e qeverisë gjen guximin të ndërtojë dhe të bëjë biznes në kundërshtim me ligjet dhe kundër të gjithëve, madje duke shpërfillur dhe UNESCO-n për të shkatërruar historinë e shqiptarëve, duke lejuar të ndërtohet brenda parkut arkeologjik të Butrintit.

Në vend që të gjendet sot para Prokurorisë që të japë llogari për skandalet e saj, Kumbaro së di ku e gjen guximin dhe fyen rininë e Bashkisë së 6-të më të madhe në vend.



Kryebashkiaku Xhelal Mziu kërkon realizimin e buxhetit deri në mbyllje të vitit

Në një mbledhje me drejtuesit e administratës, kryebashkiaku Xhelal Mziu pasqyroi realitetin e deritanishëm të gjendjes financiare të Bashkisë në realizimin e buxhetit të vitit 2017, të planifikuar në këtë fillim viti. Vëmendje maksimale dhe përkushtim në punë i të gjithë administratës së Bashkisë Kamëz në realizimin e të ardhurave nga çdo drejtori që krijon të tilla, por edhe një harmonizim të punëve nga të gjithë aktorët për të luajtur në çdo kohë rolin e tyre në mbledhjen e të ardhurave të planifikuara.

“Për të realizuar këtë së pari, - theksoi kryebashkiaku Mziu, - duhet luftë pa kompromis nga të gjitha drejtoritë për të realizuar paketën fiskale si dhe mbledhjen e debive jo vetëm nëpërmjet instrumenteve të grupeve të punës që operojnë në terren, por edhe nga të gjithë pjesëtarët e administratës për ta zbatuar ligjin me gjithë forcën e tij.

Së dyti, janë të gjitha të dhënat që zotëron Bashkia për të gjithë debitorët dhe për të gjetur rrugët e duhura të



komunikimit dhe bashkëpunimit deri në mbylljen me sukses të këtij procesi. Është e rëndësishme të kuptohet nga të gjithë subjektet private, por edhe familjare që shlyerja e detyrimeve ndaj

institucionit të Bashkisë është e rëndësishme, pasi do të jetë e pashmangshme rritja e investimeve si dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve ndaj të gjithë qytetarëve. Prandaj

“Kërkohet vlerësim maksimal nga ana e stafit administrativ të Bashkisë Kamëz për të përmbushur me rigorozitet të gjitha përpjekjet për realizimin e të ardhurave”.

duke e mbyllur fjalën kërkohet vlerësim maksimal nga ana e stafit administrativ të Bashkisë Kamëz për të përmbushur me rigorozitet të gjitha përpjekjet për realizimin e të ardhurave”.

Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit, e angazhuar për kryerjen e detyrave dhe ngritjen e ritmit dhe cilësisë së punës

Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit e Treg në Bashkinë Kamëz është angazhuar për kryerjen e detyrave dhe ngritjen e ritmit dhe cilësisë së punës. Në këtë periudhë kohore, Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit ka vijuar punën e saj normalisht, duke e intensifikuar atë në sektorët që ofron shërbim.

Të gjithë sektorët e kësaj ndërmarrjeje janë të mobilizuar dhe të angazhuar për të kryer shërbimet e përditshme, por edhe për të përballuar çdo situatë, në rast të kushteve jo të mira atmosferike në zona të ndryshme të qytetit.

Kështu, sektori i fshesës ka bërë pastrimin e rrugëve dhe trotuareve të territorit të Kamzës, Bathores dhe Paskuqanit. Puna për pastrimin e territorit ka vazhduar rregullisht sipas ditës dhe orës së caktuar. Sektori i ngarkim-shkarkimit ka vazhduar punën sipas turneve dhe lagjeve të caktuara në Kamëz, Bathore dhe Paskuqan.

Gjithashtu, është bërë edhe pastrimi i disa pikave problematike, siç është pastrimi tek Argjinatura përgjatë lumit Tërkuzë, nga kufiri me Fushë-Krujë deri në kufi me Zall-Herrin.

Ndërkaq, te pika e grumbullimit të mbeturinave ka vazhduar puna për rehabilitimin e fushës dhe mbulimin e mbeturinave me zhavorr.

Gjithashtu, ka vazhduar puna për pastrimin e varrezave që administrojnë Bashkia Kamëz, si në Laknas, Kamëz, Bathore dhe Paskuqan. Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit ofron shërbimin e pastrimit në disa zona me kontejnerë dhe në disa zona me mënyrën e mbledhjes së mbeturinave derë më derë, duke pasur kështu edhe një komunikim të drejtpërdrejtë me qytetarët. Ndërkaq, po punohet edhe për rritjen e sipërfaqeve të gjelbëruara në hapësirat publike, me qëllim që qyteti të ketë një mjedis edhe më të pastër, edhe më të shëndetshëm.

Kujdesja për pemët dekorative, një nga punët e dobishme të Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit



Mirëmbajtja e bimëve dekorative përgjatë Bulevardit Blu si dhe në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz përbën një aspekt të rëndësishëm të fokusit të shërbimeve të shumta që kryen kjo strukturë për të ofruar një mjedis sa më pastër ekologjik për qytetarët.

Edhe në këto ditë po intensifikohen shërbimet në mbrojtjen dhe krijimin e një profili ambientalist sa më funksional dhe atraktiv për qytetarët.

Të tilla shërbime janë dhe dhënia e kurorave të përshtatshme dekoracioneve kudo që ato janë të instaluar në territorin e Bashkisë dhe po punohet për zgjerimin e projekteve në drejtim të mjedisit.

Përkujdesja ndaj dekoracioneve ka si qëllim projektimin e profilit të ndryshimit të qytetit çdo ditë.

Ky aspekt tregon edhe një herë vizionin e institucionit, por veçanërisht të kryebashkiakut Xhelal Mziu për ta ndryshuar fytyrën e qytetit çdo ditë të punës së tij, ku linjat kryesore janë investimet dhe shërbimet në tërësi në dobi të qytetarëve të Kamzës.

Krijimi i një ambienti të pastër për të gjithë qytetarët e Paskuqanit

Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit është e përgatitur për të përmbushur detyrat e stinës në të gjitha funksionet e saj. Njëra prej tyre është edhe krijimi i një ambienti të pastër për të gjithë qytetarët e Paskuqanit, të cilët çdo ditë lëvizin në bulevardin “Demokracia”, investim ky i rëndësishëm i Bashkisë. Të gjithë punonjësit e kësaj ndërmarrjeje janë angazhuar për të pastruar dhe rehabilituar të gjitha sipërfaqet me bimë dekorative të mbjella përgjatë këtij bulevardi. Ky angazhim ka përcjellë te të gjithë qytetarët një vlerësim që ndërmarrja po bën dhe do të vazhdojë të bëjë përkujdesje në të ardhmen. Gjelbërimi i këtij bulevardi do të rrisë sipërfaqen e gjelbërimit në qytetin e Kamzës dhe për rrjedhojë do të rrisë përgjegjshmërinë e strukturave përgjegjëse për t’u kujdesur pikërisht për to.

Bashkia Kamëz, pjesë e projektit gjeohapësinor për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit

Në ambientet e sallës së Këshillit në Bashkinë Kamëz u zhvillua takimi në nivele ekspertësh për implementimin e projektit gjeohapësinor që ka të bëjë me marrjen dhe përpunimin e informacionit për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit në zonën Tiranë-Durrës, rajon në të cilin përfshihet edhe territori i Bashkisë Kamëz.

Takimi konsistonte me fillimin e zbatimit të projektit për krijimin e hartave topografike dixhitale si një nga elementët më të rëndësishëm për marrjen dhe përpunimin e informacionit gjeohapësinor. Bashkia Kamëz, e përfshirë brenda projektit, do të ketë shumë përfitime dhe impakti do të jetë i madh me përfundimin e procesit të dixhitalizimit të institucionit. Përfshirja e Bashkisë Kamëz në projektin e informacionit gjeohapësinor në rajonin Tiranë-Durrës nuk është thjeshtë përfshirje gjeografike, por ekspertët është vlerësim i kapaciteteve të këtij institucioni për t’u bërë pjesë serioze e zgjerimit hapësinor të tij.



Ndeshjet e Kampionatit Evropian U-19 në stadiumin e Kamzës

Kryebashkiaku Xhelal Mziu, Armando Duka dhe Dejan Savićević ndjekin ndeshjen Norvegji-Mal i Zi

Në datat 4, 7 dhe 10 tetor në stadiumin e Kamzës u zhvilluan tri ndeshje të vlefshme për Kampionatin Evropian të moshave U-19. Më datë 4 tetor u zhvillua ndeshja Norvegji-Mal i Zi, në datën 7 tetor u zhvillua ndeshja Ukrainë-Norvegji, ndërsa më 10 tetor u luajt takimi tjetër Mal i Zi-Ukrainë. UEFA kishte përzgjedhur stadiumin e Kamzës për t'u zhvilluar disa nga ndeshjet e këtij kampionati, duke parë kushtet dhe standardet bashkëkohore të stadiumit, një investim i Bashkisë Kamëz, dhe duke u shndërruar kështu një arenë ndërkombëtare sportive. Gjithashtu, stadiumi i Kamzës ka një terren sportiv mjaft të vlerësuar si dhe infrastruktura e këtij stadiumi është në



nivele evropiane. Delegati i UEFA-s, pasi kontrollon të gjitha ambientet e brendshme të stadiumit, si dhe fushën mbeti shumë i kënaqur nga infrastruktura sportive e stadiumit të Kamzës. Përkushtimi për krijimin e kësaj infrastrukture bashkëkohore është edhe vëmendja e drejtpërdrejtë e kryebashkiakut Xhelal Mziu për të pasur një stadium me parametra të niveleve evropiane.

Ndërkaq, kryebashkiaku Xhelal Mziu, presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armando Duka, dhe presidenti i Federatës të Malit të Zi, Dejan Savićević, kanë ndjekur një prej ndeshjeve, pikërisht atë ndërmjet Norvegjisë dhe Malit të Zi.

Dy fitore radhazi në Superligë

Kamza fiton në Gjirokastër ndaj Luftëtarit 1-2 dhe mposht Vllazninë 1-0



Ka ardhur 3-pikëshi i parë i Kamzës në Superligë, pas dominimit me lojë dhe me rezultatin 1-2 ndaj Luftëtarit në Gjirokastër. Në qytetin e gurtë, Kamza ishte mysafire, por ka treguar nivel të lartë të lojës, të cilën e ka treguar në fund edhe rezultati. Dy gola ka shënuar Kamza, megjithëse me një lojtar më pak. Futbollistët e Kamzës kanë qenë të karikuar, duke mos reshtur së vrapuari dhe dyluftuari. Raçiç kaloi kamzalinjtë në epërsi në minutën e 16-të, por puna e Kamzës u vështirësua pas daljes me të kuq të Fushtarit në minutën e 32-të. Bregu i Luftëtarit barazoi rezultatin në minutën e 62-të, por në minutat shtesë Miraka goditi Raçiçin me grusht, duke shkaktuar penallti dhe duke u ndëshkuar me karton të kuq. Sulmuesi serb ekzekutoi në mënyrë të saktë penalltinë, duke i dhuruar fitoren Kamzës. Trajneri Ramadan Ndreu përgëzoi lojtarët e tij që nuk dorëzohen asnjëherë dhe luftojnë deri në minutat e fundit. "Kishim katër mungesa shumë cilësore sot. I kuqi na çorientoi, megjithatë kjo skuadër ka karakter, ka grintë, ka potencial dhe po përmirësohet nga dita-ditës. Treguam në minutat e fundit që kemi fuqi për të vrapuar", - është shprehur ai.

Ndërsa në ndeshjen ndaj Vllaznisë, të zhvilluar në Kamëz, të besuarit e Ramadan Ndreut arritën ta zblloktonin rezultatin vetëm në minutën e 86-të me anë të një supergoli të Imerit, i cili realizoi me një gjuajtje të fortë nga jashtë zonës. Në Kamëz festa vazhdon, sepse kundër Vllaznisë erdhi një fitore e shkëlqyer 1-0, me gol nga Imeri në minutat e fundit. Kështu, në javën e 6-të të Kategorisë Superiore Kamza mposhti shkodranët u me rezultatin 1-0. Sulmuesi shqiptar nga Maqedonia goditi nga distanca dhe një devijim e ndihmoi të shënonte, duke ngjitur ndjeshëm Kamzën në renditje. Kamza, pas disa përpjekjeve për të kaluar e para në epërsi do të gjente golin e fitores vetëm në minutën e 86-të. Demir Imeri do të gjuante nga një distancë e largët dhe topi do të devijojë nga mbrojtësi Pjeshka, duke gjetur të papërgatitur portierin Sherri.

Kryebashkiaku Mziu i jep mbështetje ekipit Kamza Basket për fillimin e Kampionatit Kombëtar 2017-2018

Kryebashkiaku Xhelal Mziu priti basketbollistët e ekipit Kamza Basket në ambientet e zyrës së tij. Pasi i falënderoi për lartësimin e emrit të ekipit të basketbollit dhe sigurisht të Bashkisë Kamëz, z. Mziu theksoi arritjet e vitit të kaluar, siç ishte faza e play-off-it nëpërmjet përpjekjeve dhe përqendrimit të jashtëzakonshëm. Ai tha se Kamza ka arritur në të gjithë komponentët sportivë, por kryesisht në atë të basketbollit. Kryebashkiaku Mziu dha mesazhin e qartë që ai është i angazhuar për të mbështetur ekipin edhe për këtë vit. "Ju duhet të bëheni promotorë të përhapjes së sportit të basketbollit në të gjitha grupmoshat që ekzistojnë sot në të gjitha shkollat e Kamzës, talente që duhen promovuar dhe mbështetur për të bërë që në Kamëz basketbolli të jetë një sport masiv, për të gjithë të rinjtë e të rejat e qytetit. Unë do të vazhdoj t'ju mbështes, edhe pse ka vështirësi të ndryshme për rrugën që po ndërtojmë. Ju inkurajoj për punën që po bëni, duke ruajtur traditën, edhe pse ka vetëm 7-8 vite që ky sport zhvillohet në Kamëz", - theksoi kreu i Bashkisë. Më tej z. Mziu u shpreh: "Vëmendja e Bashkisë nuk është ndalur për asnjë moment në investime siç është palestra, një nga ambientet sportive të këtij lloji ndër më të mira në vend, por do të vazhdojmë të investojmë edhe në ambiente të tjera të ngjashme për të përsosur infrastrukturën e sportit të basketbollit në Kamëz. Unë e di që basketbolli është sporti i inteligjencës dhe dëshiroj që ky sport të zgjerohet dhe të marrë përmasat e duhura, që qyteti ynë të vazhdojë traditën e mirë që ka pasur në këto vite". Pasi i falënderoi edhe një herë basketbollistët kreu i Bashkisë shprehu bindjen e tij se edhe këtë vit Kamza Basket do të ketë rezultate dhe arritje të suksesshme. "Nuk më mbetet gjë tjetër vetëm t'ju falënderoj për rezultatet. Edhe pse ekipet e tjera kanë afuar lojtarë cilësorë, të blerë nga Amerika apo vende të tjera evropiane, përsëri mbetem i mendimit që rezultatet tuaja do të jenë konkurrues e, pse jo, të sjellin trofe në Kamëz", - e përfundoi fjalën e tij z. Mziu. Trajneri Adem Muhametaj si dhe të gjithë basketbollistët e pranishëm në këtë takim e falënderuan kryebashkiakun Mziu për mbështetjen e tij të drejtpërdrejtë, nëpërmjet investimeve apo financiarisht, duke i premtuar atij arritjen e sukseseve në këtë sezon të ri.

Mziu, basketbollistëve të Kamzës: Nëse gërshetoni punën, dëshirën dhe vullnetin, arrini masivizimin e basketbollit dhe trofe

Kryebashkiaku Mziu pati një takim edhe me basketbollistët dhe me trajnerin e ekipit Kamza Basket. Ky takim u zhvillua në zyrën e tij, në kuadrin e fillimit të Kampionatit Kombëtar të Basketbollit për femra për sezonin 2017-2018. Në takimin e zhvilluar me basketbollistët, z. Mziu e vuri theksin në drejtim të masivizimit të sportit të basketbollit në qytetin e Kamzës, ku theksoi se nëse gërshetohet puna, dëshira dhe vullneti së bashku mund të arrihet



jo vetëm masivizimin e basketbollit në Kamëz, por kjo premtim edhe trofe. "Qëllimi im për basketbollin ka qenë që qyteti ka nevojë për pjesëmarrjen në disiplinën të ndryshme sportive për të rritur imazhin e qytetit të Kamzës. Ndërsa qëllimi final ka konstatuar në dy drejtime: të jetë sport konkurrues për fitimin e trofeve dhe, së dyti, të krijojmë bazën e basketbollit me të reja dhe të rinj nga Kamza. Këtë vit po shikoj që po punohet shumë në këtë drejtim për të krijuar një bazë të fortë me të reja vetëm nga Kamza. Kërkoj nga ju që të inkurajoni të reja të tjera që të angazhohen me sportin e basketbollit. Ne kemi palestrën e basketbollit ndoshta më të mirën në Shqipëri. Edhe trajneri juaj do të japë impaktin e tij pozitiv në drejtim të ekipit. Jam i bindur që me aftësitë tuaja që keni do të jemi në fazën e play-off-it, pse jo, të marrim edhe trofe, pasi ju keni harmonizim në ekip. Do të gjejmë mundësinë për t'ju mbështetur edhe financiarisht nëse arrini objektivat e vëna tani në fillim të kampionatit. Gjithashtu do të gjejmë edhe zgjidhje stimuluese. Kërkoj që ekipi të jetë konkurrues ashtu si ekipi i meshkujve që ka fituar shumë trofe. Të jetë sport masiv, këtë e vlerësoj shumë, më pas trofetë. Ndërsa një problematikë që unë shikoj është se ka akoma punë për masivizimin e basketbollit në drejtim të shkollave, pasi sporti i basketbollit përveçse ju mban në formë sportive është sport edhe inteligjent". Këto ishin disa nga fjalët e kryebashkiakut Mziu në bashkëbisedim që pati me ekipin e vajzave të Kamza Basket.

Trajneri i ekipit të femrave të Kamzës, Maksim Kristo, tha se te këto vajza sheh një preokupim dhe dashuri të madhe për sportin e basketbollit: "Kjo vjen për shkak të infrastrukturës dhe më bën mua si trajner të punoj në komoditet. Ky komunitet vjen edhe për shkak të mbështetjes së kryetarit dhe infrastrukturës moderne dhe premtim që do të kemi një ekip shumë më konkurrues sesa vjet". Ndërkohë, të gjitha basketbollistët falënderuan kryetarin për infrastrukturën moderne në palestrën e Bathores si dhe për mbështetjen e vazhdueshme që u ka dhënë, ndërsa i premtuan kryebashkiakut Mziu që do t'i realizojnë të gjithë objektivat e vënë.

Kamza Karate, 22 medalje në Kupën e Shqipërisë dhe paraqitje mjaft të mirë në "Struga Open 2017"

Ekipi Kamza Karate ka pasur paraqitje mjaft të mira gjatë kësaj periudhe. Kështu, në turneun e 14-të ndërkombëtar "Struga Open 2017", që u zhvillua më 7.10.2017 në Strugë të Maqedonisë, ku morën pjesë 5 shtete të ndryshme me 477 sportistë gjithsej, Kamza Karate u përfaqësua me 7 garues, të cilët ishin Ernik Pjetri, Valentino Tanushi, Robert Maklekaj, Danjoll Mehmetaj, Lion Zmali, Aristidh Buci. Me medalje ari u kurorëzua Ernik Pjetri, medalje bronzi Roberto Maklekaj, ndërsa medalje argjendi Danjoll Mehmetaj, Valentino Tanushi, Aristidh Buci, Lion Zmali, Jurges Muka. Ky ishte kampionati i parë që Kamza Karate merr pjesë si ekip për sezonin e ri 2017-2018. Paraqitja e ekipit ishte mjaft e mirë, ku konkurrenca

dhe niveli sportiv ishte i lartë. Kamza Karate ka vijuar sukseset e saj kombëtare dhe ndërkombëtare edhe në Kupën e Republikës, ku u kurorëzua me 22 medalje.

Në pallatin e sportit "Asllan Rusi", më 14.10.2017, u zhvillua Kupa e Shqipërisë për të gjitha grupmoshat. Edhe këtë vit ekipi i Kamzës u ngjiti në podium. Kamza u përfaqësua me 24 sportistë dhe fitoi 5 medalje ari, 9 medalje argjendi dhe 8 medalje bronzi. Nga këta, me medalje ari u stolisën Aristidh Buci, Danjoll Mehmetaj, Ernik Pjetri, Ervin Kadriu dhe Joni Noka. Ndërkohë, ekipi vazhdon përgatitjet intensive për Kampionatin Kombëtar për kadet, junior dhe senior, që do të zhvillohet më 5 nëntor në Tiranë.